



3918 Prot
26.06.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 415/1 prot.

Shkodër, më 22.06.2023

Lënda: Mbi mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 48, pikat 1, 2, 4, 5, 6, 7, neni 50, neni 54, shkronja “b”, “i”, neni 55, VKB nr.23/2020 “Rregullore e brendshme e KB” Vendimit të KQZ-së Nr. 573, datë 24.05.2023 “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës”, shkresa përcjellëse Nr. 3757 prot., datë 16.06.2023 (protokolluar me tonën datë 19.06.23) mbi dokumentacionin e mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të konstituar me datë 13.06.2023”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, u miratuan aktet e mbledhjes së parë të konstituimit të Këshillit Bashkiak si vijon:

- a. VKB Vau Dejës Nr. 41, datë 13.06.2023 “Zgjedhja e komisionit të mandateve”,
- b. VKB Vau Dejës Nr. 42, datë 13.06.2023 “Për miratimin e mandateve të 28 këshilltarëve, sipas listës bashkëlidhur”,
- c. VKB Vau Dejës Nr. 43, datë 13.06.2023 “Për zgjedhjen e komisionit të votimit për Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e Këshillit Bashkiak”,
- d. VKB Vau Dejës Nr. 44, datë 13.06.2023 “Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Z. Ervis Shemsi Shimaj me 25 vota pro, forca politike PSD”,
- e. VKB Vau Dejës Nr. 45, datë 13.06.2023 “Për zgjedhjen e zëvendës Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, Z. Frano Gjon Prenga me 23 vota pro, forca politike PSD”
- f. VKB Vau Dejës Nr. 46, datë 13.06.2023 “Për zgjedhjen e zëvendës kryetarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, Zj. Paola Gjon Pleshaj, me 25 vota pro, forca politike PS”
- g. VKB Vau Dejës Nr. 47, datë 13.06.2023 “Për zgjedhjen e komisionit të votimit për përfaqësuesit e anëtarëve të Këshillit të Qarkut”
- h. VKB Vau Dejës Nr. 48, datë 13.06.2023 “Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut Shkodër;
1. Kristjana Gjovalin Kovaçi 22 vota vota pro,
2. Arsen Smajl Mehmeti 20 vota pro,
3. Ermir Egerem Tahiri 19 vota pro,
4. Mirela Ndue Vasija 16 vota pro,

Prefekti lejon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 41 Datë 13 . 06 2023

“Zgjedhjen e komisionit të mandateve”

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 48, **Mbledhja e parë e këshillit bashkiak**, pika 6 , gërma a) *Zgjidhet komisioni i mandateve* ; pika 5, *Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë*; neni 54, **Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**, gërma a) *zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet, neni 55, pika 3, Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji*; Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e tij të parë;

VENDOSI:

1. Zgjedhjen e komisionit të mandateve, mbështetur ne nenin 55, pika 3 me shumice të votave, si më poshtë :
Neki Kapllanaj- Kryetar
Marin Dodaj – Sekretar
Kristjana Kovaçi – Anetare
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian CELEPIJA

Këshilltari më i vjetër në moshë
Frano Prenga

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 16.06.23